



A.nr.2056/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.2056/2025, të datës 22.12.2025, të parashtruar nga ankuesi D.H.nga Prishtina, kundër organit të punësimit: Ministrisë së Mbrojtjes, në çështjen juridike “*shkelje e të drejtës në pagë*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3, dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe në mbështetje të nenit 132, paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, më datë 05.06.2026, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.2056/2025, e datës 22.12.2025, e parashtruar nga ankuesi D.H.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil, D.H.(*tutje referuar vetëm si: ankuesi*), më datë 22.12.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër Përgjigjes me numër protokollit 6190, të datës 16.12.2025 të u.d Drejtorit të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Mbrojtjes.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli*), bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Mbrojtjes, ndërsa, kjo e fundit, ka dorëzuar përgjigjen në ankesë, duke dhënë përgjigje në pretendimet ankimore të ankuesit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin në vijim Kolegji i Këshillit) administroi këto prova: Ankesën me numër protokollit 7997/2025 të datës 22.12.2025 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesë-ankesë e datës 05.12.2025 nga ankuesi për u.d Drejtorin e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Mbrojtjes; Përgjigjen në kërkesë e datës 16.12.2025 nga u.d Drejtori i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Mbrojtjes për ankuesin; Akt Emërimin e datës 31.10.2025; Akt Emërimin e datës 17.10.2019; Listën e pagave për ankuesin tetor dhe nëntor 2025; Dëshmi nga lista e pagave për një nëpunës të kategorisë së ulët drejtuese; Kopjen e ID-së së ankuesit; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 26.12.2025; Përgjigjen në ankesë e datës 31.12.2025; Shkresë për kategorizimin e të gjitha kategorisë të personelit në Ministri të Mbrojtjes dhe në FSK e datës 06.10.2025; Listën e dërguar në DMZP nga Ministria e Mbrojtjes për

kategorizim të pozitive të nivelit profesional dhe drejtues në muajin tetor 2025; Dëshmi të sistemit të pagave të stafit civil në MFSK dhe FSK; Organogramin e Ministrisë së Mbrojtjes; Listat e pagave për ankuesin dhjetor 2022, janar-dhjetor 2023, janar-dhjetor 2024 dhe janar-dhjetor 2025; Vendimin A.nr.1004/2024 të KPMSHCK-së; Kërkesën e datës 06.01.2026 nga A.B. për A.H. për prova shtesë; Përgjigjen e datës 08.01.2026; Listën e pagave janar 2023 dhe dhjetor 2025 për Q.Xh. dhe A.H.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të dorëzuara nga palët në procedurë si dhe pretendimeve ankimore të ankuesit ka gjetur së ankesa e ankuesit **është e pabazuar, sepse:**

Gjendja e çështjes

Nga administrimi i provave të lëndës rezulton se:

- Ankuesi fillimisht sipas Akt Emërimit të datës 17.10.2019, ka mbajtur pozitën Shef i Zyrës së Arkivit në Ministrinë e Mbrojtjes sipas gradës A3, ndërsa, për pozitë të njëjtë më datë 31.10.2025, i është lëshuar Akt Emërimi Nr:5/948/2025 të datës 31.10.2025, më klasë Drejtues i ulët drejtueses, koeficienti 8.4.
- Ankuesi para hyrjes në fuqi të Ligjit Nr. 08/L-196 për Agat në Sektorin Publikë ka përvetësuar pagë sipas gradës A3 (sistem ekuivalent me gradat e ushtareve i aplikuar sipas akteve të brendshme ligjore), në vlerë prej 1,049.22 Euro.
- Me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, ankuesi sipas Vendimit Nr.04/128 të datës 16.02.2023, të Qeverisë së Kosovës, është kategorizuar në klasën profesional 1, dhe nga muaji shkurt 2023 deri në muajin nëntor 2025, ka realizuar pagë bazë sipas klasës profesional 6.75 si dhe shtesën tranzitore duke realizuar pagë bruto prej 1,049.22 Euro.
- Me ndryshimet sipas Akt Emërimit Nr:5/948/2024 të datës 31.10.2025, pozita e ankuesi është kategorizuar në kategorinë e ulët drejtuese, koeficient 19, grada A3, dhe nga muaji nëntor i vitit 2025 , ankuesi realizon pagë sipas kategorisë së ulët drejtuese, koeficientit 8.4 dhe shtesën tranzitore, ashtu që paga bruto është 1,049.22 Euro.
- Ankuesi më datë 05.12.2025 i është drejtuar u.d Drejtorit të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Mbrojtjes, me të cilën ka kërkuar kompensimin për 26 muaj të pagës sipas kategorisë së ulët drejtuese meqë për plotë 26 muaj është paguar gabimisht në kategorisë profesionale klasa profesional 1.
- Ushtruesi i Detyrës së Drejtorit të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Mbrojtjes, më datë 16.12.2025, përmes përgjigjes në kërkesë me numër protokoll 6190, ka informuar ankuesin se pozita Shef i Zyrës së Arkivës pas hyrjes në fuqi të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, nga DMZP është kategorizuar në klasën profesional 1 dhe ky kategorizim është pasqyruar në listën e pagave por që ankuesi ka realizuar shtesë tranzitore duke e ruajtur nivelin e pagës para hyrjes në fuqi të ligjit për pagat në sektorin publik, dhe meqë në mars të vitit 2025 kemi pasur procedurën e rekrutimit për pozitën Shef i Zyrës për Menaxhimin e Aseteve, të cilës i është njohur kategoria e ulët drejtuese, atëherë është ngritur çështja e rregullimit të kategorisë edhe për pozitën ankuesi, dhe kjo ka ndodhur sipas akt emërimit të ri. Ndryshimi i pagës bazë nga klasa Profesional 1 në Drejtues të ulët, ndryshon në pagën bazë, zvogëlimin e shtesës tranzitore mirëpo nuk ka ndryshim në pagën bruto dhe neto.

Pretendimet ankimore

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se akti i kontestuar nuk trajton kërkesën lidhur me dëmin prej 26 muaj ku pozita është trajtuar gabimisht në listën e pagave, pasi që kjo ka ndikuar në të drejta të tjera psh. bazën e pagës, përvojën e

punës mbi pagën bazë, progresin, trajtim në sistematizim, të drejta nga pozita udhëheqëse etj. Tutje, pretendon se ka diskriminim mes pagave për kategorisë e ulët drejtuese gjegjësisht në rastin e tij paga është 1.048.22 euro ndërsa, tek një rast tjetër 1,083.98 Euro. Kërkon që ankesa të aprovohet, të shfuqizohet akti i atakuar të obligohet Ministria e Mbrojtjes të nxjerr akt të ri ku të përcaktoj dhe të zbatoj kategorizimin korrekt të pozitës sime për periudhën e kontestuar, të bëjë llogaritjen e të gjitha elementeve të pagës dhe të realizoj kompensimin retroaktiv për çdo diference që rezulton dhe të korrigjon evidencat në dosjen time dhe raportimet përkatëse.

Vlerësimi i Kolegjit

Kolegji i Këshillit për trajtim të drejtë dhe meritore të çështjes ankimore, iu referua:

I. Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë:

- Neni 22 [E drejta e pagës] *Për orët e punës së kryer, zyrtarja/i publik ka të drejtën e pagës. Paga e zyrtares/it publik rregullohet me Ligjin përkatës për Pagat në Sektorin Publik.*
- Neni 27 [E drejta për informim për marrëdhënien e punës dhe e drejta e ankesës] *Zyrtarja/i publik ka të drejtë të informohet për procedurat dhe vendimet lidhur me marrëdhënien e saj/tij të punës. 2. Zyrtarja/i publik ka të drejtë të qasjes në dosjen e saj/tij individuale dhe të kërkoj ndryshimin dhe plotësimin e të dhënave në dosje. 3. Nëpunësja/i civil ka të drejtë të paraqes ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto që burojnë nga marrëdhënia e punës në shërbimin civil. 4. E drejta e ankimit në KPMSHCK i njihet edhe çdo kandidateje/i në procedurë pranimi në shërbimin civil. 5. Pas shterimit të drejtës së ankimit në KPMSHCK sipas paragrafit 3. dhe 4. të këtij neni, mund të iniciohet konflikt administrativ në gjykatën kompetente për çështjet administrative, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.*

II. Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik:

- Neni 1 [Qëllimi]: *1. Qëllimi i këtij ligji është që të krijojë një sistem të njëtrajtshëm të pagave në sektorin publik që përfshin parimet dhe rregullat për përcaktim të pagës në sektorin publik si dhe të krijojë një sistem të pagave dhe shpërblimeve, transparent dhe të menaxhoheshim ku elementi kryesor është paga bazë.*
- Neni 3: *1.10. paga mujore apo paga – nënkupton kundërvlerën monetare që përfshin pagën bazë, shtesat dhe të drejtat e tjera të pagës, që për qëllimin e këtij ligji trajtohet si pagë primare;*
- Neni 6: *“6. Paga bazë rritet në bazë të përvojës së punës, në masën: 6.1. zero pikë njëzetë e pesë për qind (0.25%) për çdo vit të plotë pune, deri në pesëmbëdhjetë vite (15) punë; dhe 6.2. zero pikë pesë për qind (0.5%) për çdo vit të plotë pune, mbi pesëmbëdhjetë vite (15) punë*
- Neni 13 [Paga e se: *“6. Paga bazë rritet në bazë të përvojës së punës, në masën: 6.1. zero pikë njëzetë e pesë për qind (0.25%) për çdo vit të plotë pune, deri në pesëmbëdhjetë vite (15) punë; dhe 6.2. zero pikë pesë për qind (0.5%) për çdo vit të plotë pune, mbi pesëmbëdhjetë vite (15) punë nëpunëses/it civil] : “Paga e nëpunëses/it civile përbëhet nga paga bazë, shtesat dhe kompensimet, kur shtesat dhe kompensimet janë të aplikueshme sipas këtij ligji”.*
- Nenit 14, paragrafi 3: *3. Klasifikimi i një pozitë të caktuar të shërbimit civil, bëhet në bazë të rregullave të vlerësimit dhe klasifikimit të pozitave të punës, sipas dispozitave për klasifikimin e pozitave të shërbimit civil, në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik”*

-Nen 41 [Shtesa tranzitore] 1. Nëse një zyrtar/e publik/e apo funksionar/e publik/e, para hyrjes në fuqi të këtij ligji përfitonte pagë që është më e madhe se paga e plotë e parashikuar me këtë ligj, ajo/ai do të përfitojë pagën e re sipas dispozitave të këtij ligji dhe shtesën tranzitore të barabartë me diferencën ndërmjet pagës aktuale dhe pagës së re bazë. 2. Të punësuarat/it, zyrtarja/i publik/e apo funksionarja/i publik/e, në pajtim me paragrafin 1. të tij neni, do të përfitojë pagën e re në: 2.1. 100% të shtesës tranzitore të posaçme, sipas paragrafit 1, gjatë vitit të parë pas hyrjes në fuqi të këtij ligji; 2.2. 50 % të shtesës tranzitore të posaçme, sipas paragrafit 1, gjatë vitit të dytë pas hyrjes në fuqi të këtij ligji. 3. Përgjashtimisht nga paragrafi 1. dhe 2. i këtij neni, anëtarët/ët e shërbimit të jashtëm nuk gëzojnë të drejtën e shtesës tranzitore. 4. Çdo person që punësohet pas miratimit të këtij ligji përfiton pagën sipas këtij ligji dhe nuk gëzon të drejtën e shtesës tranzitore.

Rrjedhimisht, Ligji Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik i është nënshtruar vlerësimit të kushtetutshmërisë nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, e cila më Aktgjykimin AGJ 2316/24, 23 janar 2024, në rastin nr. KO79/23, ka vendosur se: IV. TË KONSTATOJE se paragrafi 2 i nenit 41 (Shtesa tranzitore) të Ligjit nr. 08jL-196 për Pagat ne Sektorin Publik nuk është në përputhshmëri me paragrafët 1 dhe 2 të nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 1 (Mbrojtja e Pronës) të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe paragrafin 1 ë nenit 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit] dhe paragrafin 1 të nenit 7 [Vlerat] të Kushtetutës; V. TË KONSTATOJE se paragrafi 3 i nenit 41 (shtesa tranzitore) të Ligjit nr. 08jL-196 për Pagat ne Sektorin Publik nuk është në përputhshmëri me paragrafët 1 dhe 2 të nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të kushtetutës në ndërlidhje me nenin 1 (Mbrojtja e Pronës) të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe paragrafin 1 të nenit 24 [Barazia para Ligjit] të kushtetutës ne ndërlidhej me nenin 14 (Ndalimi i diskriminimit) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; VI. TË KONSTATOJE se paragrafi 4 i nenit 41 (shtesa tranzitore) të Ligjit nr. 08jL-196 për Pagat ne Sektorin Publik nuk është në përputhshmëri me paragrafin 1 të nenit 24 [Barazia para Ligjit] të kushtetutës ne ndërlidhje me nenin 1 (Ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit) të Protokollit nr. 12 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; VII. TË SHPALLË të pavlefshëm paragrafët 2, 3 dhe 4 të nenit 41 (shtesa tranzitore) dhe paragrafin 2 të nenit 45 (Shfuqizimi) të Ligjit nr. 08jL-196 pre Pagat ne Sektorin Publik, nga hyrja ne fuqi e këtij Aktgjykimi;

Konstatimin si më sipër, Gjykata Kushtetues e kishte sqaruar sipas pikës 383 dhe 385, ashtu që, e njëjta ka përcaktuar se: 383: Ndërsa, në balancimin në mes të drejtave dhe lirive themelore dhe parimit të sigurisë juridike dhe parashikueshmërisë, Gjykata, përmes këtij Aktgjykimi do të shpallë të pavlefshme dhe do të shfuqizojë paragrafët 2, 3 dhe 4 të nenit 41 të Ligjit të kontestuar. Shfuqizimi i paragrafëve që ndërlidhen me periudhën tranzitore, bazuar në paragrafin 1 të nenit 41 të Ligjit të kontestuar, ka pasojën e (i) mbajtjes së nivelit ekzistues të pagave në sektorin publik, përkatësisht pamundësinë e zbritjes së pagave deri sa paga e re të 1 bëhet e barasvlershme me pagën aktuale; (ii) kthimin e pagës të paktën në nivelin para hyrjes në fuqi të Ligjit të kontestuar për kategorinë e shërbimit të jashtëm të Republikës së Kosovës dhe të cilët nuk kanë përfituar nga shtesa tranzitore prej njëqind për qind (100%) përgjatë vitit 2023, për dallim nga të gjitha kategoritë tjera; dhe (iii) nivelizimin e pagave të funksionarëve/zyrtarëve/nëpunësve që janë punësuar pas hyrjes në fuqi të Ligjit të kontestuar sipas përcaktimeve të pikës 1.4 të nenit 4 (Parimet e sistemit të pagave) të Ligjit të kontestuar”. “385. Bazuar në pretendimet dhe argumentet e parashtruara para saj, Gjykata nuk ka trajtuar Shtojcat që janë pjesë përbërëse e nenit 44 të Ligjit e kontestuar. Përkundër faktit që (i) bazuar në vet Ligjin e kontestuar, ulja

e pagës mund të bëhet vetëm si rezultat i një tronditje makroekonomike e cila rezulton në zvogëlimin e të ardhurave dhe/ose një fatkeqësie natyrore sipas kuptimit të nenit 131 të kushtetutës, përkatësisht shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme në Republikën e Kosovës; dhe (ii) emëruesit të përbashkët të praktikës gjyqësore të Gjykatave tjera Kushtetuese, GJEDNJ-së dhe GJDBE-së, që ulja e pagës, në parim, mund të bëhet vetëm në rrethana të krizave ekonomike dhe/ose financiare, Gjykata ka vlerësuar qëllimin e Ligjit të kontestuar për të krijuar “një sistem të njëtrajtshëm të pagave në sektorin publik” si qëllim legjitim. Për pasojë, ajo nuk ka shpallur në kundërshtim me Kushtetutën nenin 44 të Ligjit të kontestuar përkitazi me Shtojcat në lidhje me paragrafin 1 të nenit 45 të Ligjit të kontestuar që përfshinë shfuqizimin e një numri të dispozitave të ligjeve të veçanta dhe të cilat rregullojnë pagën e një numri institucionesh në Republikën e Kosovës... Sipas sqarimeve të dhëna në Aktgjykim, “një sistem të njëtrajtshëm të pagave në sektorin publik” arrihet përmes paragrafit 1 të nenit 41 të Ligjit të kontestuar dhe sipas të cilit, nëse një zyrtar/e publik/e apo funksionar/e publik/e, para hyrjes në fuqi të këtij ligji përfitonte pagë që është më e madhe se paga e plotë e parashikuar me këtë ligj, ajo/ai do të përfitojë pagën e re sipas dispozitave të këtij ligji dhe shtesën tranzitore të barabartë me diferencën ndërmjet pagës aktuale dhe pagës së re bazë.

Andaj, referuar bazës ligjore dhe kushtetuese si më lart, Kolegji i Këshillit konstaton se paga bazë e nëpunësit civil përcaktohet sipas klasës së pagës, përkatësisht koeficientit të cilit i përket pozita e punës, e klasifikuar në shtojcat e Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, ndërsa, klasifikimi i një pozitë të caktuar të shërbimit civil, bëhet në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik dhe rregulloren e aplikueshme për klasifikimin e vendeve të punës në Shërbimin Civil. Rrjedhimisht, sipas Aktgjykimit në rastin nr. KO79/23, paragrafët 2, 3 dhe 4 të nenit 41 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik janë shpallur të pavlefshme duke u konsideruar kushtetues vetëm paragrafi 1 i këtij neni, ndërsa, nëse një zyrtar/e publik/e apo funksionar/e publik/e, para hyrjes në fuqi të këtij ligji përfitonte pagë që është më e madhe se paga e plotë e parashikuar me këtë ligj, ajo/ai do të përfitojë pagën e re sipas dispozitave të këtij ligji dhe shtesën tranzitore të barabartë me diferencën ndërmjet pagës aktuale dhe pagës së re bazë, e drejtë kjo që realizohet në pajtim me nenin 41 paragrafi 1 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik.

Thënë si lartë, Kolegji duke u bazuar në provat e lëndës ka gjetur së Ministria e Mbrojtjes para hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, për nëpunëset civilë ka aplikuar sistem të pagave ekuivalent më gradat e personelit ushtarak, dhe mbi këtë bazë rezulton së pagat e nëpunësve civilë të Ministrisë së Mbrojtjes kanë qenë më të larta se pagat e nëpunësve civil në ministritë tjera, ndërsa, më hyrjen në fuqi të këtij ligji është bërë unifikimi i sistemit të pagave, ashtu që, nëpunësit civil të Ministrisë së Mbrojtjes realizojnë pagë sipas shtojcës 10.6 të ligjit, kurse personeli ushtarak realizojnë pagë sipas shtojcës 4 të këtij ligjit. Andaj, në ndërlidhje me këtë konstatim, Kolegji duke u bazuar në shqyrtimin e provave materiale të çështjes ka gjetur se ankuesi para hyrjes në fuqi të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë ka realizuar pagë sipas Gradës A3, në atë mënyrë që sipas listës së pagës për muajin dhjetor 2022 dhe janar 2023 paga bruto ankuesit (paga bazë dhe shtesat tjera të aplikuara në atë kohë) ka qenë 1,049.22 Euro, ndërsa, pas hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në zbatim të Vendimit Nr.04/128 të datës 16.02.2023, të Qeverisë së Kosovës lidhur me ekuivalencën e sistemit të vjetër me sistemin e ri të klasifikimit të koeficienteve me qëllim të llogaritjes së pagës, pozitën e ankuesit e ka ekuivalentuar në kategorinë profesionale 1, më koeficient I12-5.75, dhe nga muaji shkurt 2023 ankuesi sipas listës së pagave është paguar sipas koeficientit të klasës profesional 1 apo 5.75 (6.75 në vitin 2025 e tutje) duke ju llogaritur

edhe shtesa tranzitore në diferencën e caktuar, në atë mënyrë që ankuesi ka ruajtur nivelin e pagës bruto mujore prej 1,049.22 Euro.

Rrjedhimisht, bazuar në konstatimet si më sipër, rezulton së nuk gjejnë mbështetje pretendimet ankimore së ankuesit që ti behët korigjimi i pozitës dhe kompensimi i diferencës në mënyrë retroaktive të të gjitha shtesave dhe kompensimeve, sepse, për qëllime të realizmit të pagës pozita e ankuesit ishte ekujvalentuar në klasën profesional 1, më koeficient të pagës 5.75 duke aplikuar edhe shtesën tranzitore. Në fakt, ankuesi ka ruajtur pagën e plotë që ka realizuar para hyrjes në fuqi në ligjit për pagat në sektorin publik, gjegjësisht në vlerë prej 1,049.22 Euro, në atë mënyrë që paga bazë është kalkuluar sipas koeficienti 5.75 (6.75 në vitin 2025) plus shtesa tranzitore, ndërsa, me Akt emërimin e datës 31.10.2025, pozita e ankueses është klasifikuar si pozitë e kategorisë drejtues i ulët më koeficient 8.4, ashtu që, ankuesi nga muaji nëntor 2025, ka realizuar pagë sipas koeficientit 8.4 apo në vlerë 924 Euro, dhe në këtë rast është aplikuar edhe shtesa tranzitore në vlerën 90.57 Euro, për të ruajtur nivelin e pagës bruto mujore prej 1,049.22 Euro si pagë që ankuesi ka realizuar para ligjit për pagat në sektorin publik, kështu që, nisur nga këto fakte ankuesi nuk ka pësuar ndonjë dëm në kuptim të pagës, sepse, ankuesi ka ruajtur nivelin e pagës bruto mujore (të plotë) duke realizuar pagë bazë sipas profesional 1, përvojën e punës dhe rritjen e koeficienti në janar të vitit 2025, duke nënkuptuar se çdo rritje e përvojës së punës apo rritje e koeficientit ka zvogëluar vlerën e shtesës së tranzitore për shumën buto të rritjes së koeficiente apo përvojës së punës, që nënkupton edhe sikurse do të aplikohet koeficienti i pagës në raport më ankuesin sipas klasës se ulët drejtues, serish ankuesi do të realizonte pagë të njëjtë bruto, përfshirë shtesat tjera lidhur me pagën, ashtu sikurse është duke realizuar sipas akt emërimit të datës 31.10.2025. Në fakt, aplikimi retroaktiv i kategorizimit të pozitës së ankuesit është i pamundur sepse ekujvalentimi i pagës sipas Vendimit të Qeverisë Nr.04/128 të datës 16.02.2023 nuk është klasifikim i pozitës së ankuesit por ekujvalentimi i pozitës për qëllime të realizmit të pagës (ekujvalentim të cilin ankuesi asnjëherë nuk e kishte kontestuar) sepse, siç u tha me lartë klasifikimi i një pozite behët nga organi punëdhënës në pajtim më dispozitat ligjore dhe se aplikimi i ekujvalentimit të pagës sipas Vendimit të Qeverisë Nr.04/128 të datës 16.02.2023 nuk ka efekt tek kategorizimi i pozitës së ankuesit.

Lidhur me pretendimin e ankuesit se ka diskriminim mes pagave për kategorinë e ulët drejtuese gjegjësisht pretendon se në rastin e tij paga është 1.049.22 euro ndërsa tek një rast tjetër 1,083.98 Euro, Kolegji i Këshillit nga analizimi i shkresave të lëndës të dërguar nga Ministria e Mbrojtjes ka gjetur së sipas sistemit të gradave që ka zbatuar Ministria e Mbrojtjes para hyrjes në fuqi Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, disa pozita të caktuara të kategorisë së ulët drejtuese, janë paguar sipas Gradës A4, që nënkupton kanë pasur pagë të lartë se grada A3, siç është rasti më zyrtaret Q.Xh dhe A.H, të cilët sipas listave të pagës në muajin janar 2023, janë paguar sipas Gradës A4 apo sipas pagës mujore bruto 1,233.90 Euro, kështu që, edhe në raport me këta zyrtarë, e në mënyrë të njëjtë sikurse ankuesi është aplikuar shtesa tranzitore e cila është barasvlerësuar me pagën që ka pasur para hyrjes në fuqi të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë. Pra, mbi këto rrethana, Kolegji nuk ka arritur të konstatoj rrethana diskriminuese të ankuesit në kuptim të pagës e në raport me zyrtaret e tjerë që kanë pozitë të kategorisë se ulët drejtuese.

Theksuar si më sipër, e në mbështetje të nenit 18, paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë- Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

A.nr.2056/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- *Ankuesit D.H;*
- *Ministrisë së Mbrojtjes: Sekretarit të Përgjithshëm dhe Udhëheqësit të NJBNJ dhe*
- *Arkivit të KPMSHCK-së.*